



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 35, Datë 10.02.2025

MBI

**PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA  
FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN JANAR 2025 PËR KLIENTËT  
E LIDHUR NË NIVELIN E TENSIONIT 35 KV**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 4 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 04.12.2017, e ndryshuar; dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.02.2025, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 891 prot., datë 07.02.2025, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin janar 2025 për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV”,

**Konstatoi se:**

- FSHU sh.a me shkresën nr. 478 prot., datë 31.01.2025, protokolluar me tonën me nr. 891 prot., datë 31.01.2025, ka depozituar kërkesën për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për muajin dhjetor 2024, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.
- Bazuar në aplikimin e sipërcituar, për muajin janar 2025 shoqëria FSHU sh.a. e ka siguruar sasinë e energjisë elektrike për mbulimin e kërkesës për energji të kësaj kategorie klientësh nëpërmjet blerjeve mujore në Bursën Shqiptare të Energjisë (ALPEX).
- Për përlllogaritjen e çmimit mesatar të ponderuar të blerjes së energjisë elektrike për këtë periudhë (ÇBEt), FSHU sh.a. është bazuar në blerjet ditore/mujore të saj në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike për muajin janar 2024, profilet ditore të prokuruar në Bursë, çmimin ditor/orar si dhe vlerën e faturës ditore.
- Referuar të dhënave të mësipërme, rezulton se çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë elektrike (ÇBEt) i përlllogaritur nga shoqëria për muajin janar 2025 është 14.27 lekë/kwh. Për efekt kontrolli të të dhënave të paraqitura, u konsiderua e arsyeshme rilllogaritja e tyre, nga e

cila rezultoi se mesatarja e ponderuar e çmimit të blerjes së energjisë elektrike është 14.27 lekë/kwh.

- Mbështetur në nenin 8 të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 201, datë 04.12.2017, e ndryshuar, komponentët që janë marrë në konsideratë për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin janar 2025 janë: kostot administrative, tarifa e shërbimit të rrjetit të transmetimit, tarifa e shërbimit të rrjetit të shpërndarjes si dhe kursi i këmbimit i përdorur për blerjen e energjisë elektrike në treg të parregulluar.
  - **Tarifa e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike** për periudhën 1 janar 2025 – 31 Dhjetor 2027, e miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 279, datë 16.12.2024, është 0.85 lekë/kWh.
  - **Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivel tensioni 35 kV**, në zbatim të vendimit të bordit të ERE nr. 288, datë 23.12.2024, “Mbi lënien në fuqi të vendimit të bordit të ERE-s nr. 73, datë 13.04.2022”, është 1.55 lekë/kWh.
  - **Kostot administrative**, prej 1.06 lekë/kWh.
  - **Kurset zyrtare të këmbimit të publikuara nga Banka e Shqipërisë (Lekë/Euro)**, për çdo datë respektive të harkut kohor 31.12.2024 – 30.01.2025.
- Në zbatim të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, referuar aplikimit të FSHU sh.a. si dhe mbështetur në llogaritjet e ERE-s, çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin janar 2025, përlllogaritet si më poshtë:

<b>Çmimi i energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për muajin janar 2025</b>		
	<b>Njësia</b>	<b>Çmimi</b>
CBEt	Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë elektrike	Lekë/kWh 14.27
Pr	Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Lekë/kWh 0.43
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Lekë/kWh 1.06
TRr	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Lekë/kWh 0.85
TSHt	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Lekë/kWh 1.55
<b>Çmimi i energjisë = CBEt + Pr * CBEt + TRr + TSHt + CA</b>		<b>Lekë/kWh 18.16</b>

- Bazuar në çdo element të formulës llogaritëse si dhe duke marrë në konsideratë të dhënat e paraqitura në aplikimin e shoqërisë, rezulton se:
  - Çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit do të jetë *18.16 Lekë/kWh për muajin janar 2025*.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin janar 2025 prej 18.16 Lekë/kWh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.
2. Ndryshimi i secilit element përbërës në llogaritjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për kategoritë e klientëve të cilësuar në këtë vendim, do të përbëjë shkak për rishikimin e këtij vendimi nga bordi i ERE-s.
3. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR  
ANËTAR I BORDIT TË ERE  
Erjola SADUSHI**